



ÇKA NUK MUND TË SHMANGNI



**ÇKA NUK MUND TË
SHMANGNI**

Hyrje

Kur ju nuk keni kohë të gjatë për të qëndruar në një vend, apo kur thjesht konsideroni se një vend nuk duhet t'ju marrë shumë kohë, doni të dini paraprakisht çka do të mund të vizitonit, apo shijonit. Një udhëzues sado i thjeshtë mund t'ju ndihmojë të vendosni.

Meqë ju jeni këtu për një kohë të shkurtër dhe të çmueshme, ne kemi përgatitur për ju një guidë të shkurtër me disa gjëra që nuk duhet t'i shmangni. Që ju ta keni më të qartë pse mendojmë se këto gjëra janë të domosdoshme, ne kemi bërë një përshkrim të shkurtër dhe të thuktë për secilën prej tyre, duke u mbështetur në të dhëna të sigurta dhe të përditësuara. Por, mos harroni, më e mira ju pret pasi të nisni t'i viheni punës.

Ne kemi përzgjedhur për ju të paktën nga një gjë prej secilës komunë të rajonit, duke u përqendruar mbi të gjitha të natyra, kultura dhe kuzhina.

MALET E SHARRIT

Janë atraksioni natyror më i rëndësishëm jo vetëm në rajonin e Prizrenit por edhe në tërë Kosovën. Kanë një diversitet biologjik mjaft të theksuar. Flora dhe vegetacioni janë të pasura me lloje të ndryshme. Në mesin e tyre, 86 sosh janë me rëndësi ndërkombëtare, 26 lloje në “Listën e Kuqe” europiane të shtazëve dhe bimëve të rrezikuara dhe 32 janë në “Listën e Kuqe” të bimëve të rrezikuara sipas IUCN-it. Sipas IUCN (Unionit botëror për Ruajtjen dhe Konservimin e Natyrës) Parku Kombëtar Malet e Sharrit është evidentuar në listën ndërkombëtare të zonave të mbrojtura.

Klima kontinentale, me dimra të gjatë dhe reshje të mëdha të dëborës dhe verëra të freskëta.

Një pasuri e veçantë e këtyre maleve janë edhe liqenet. Liqenet glacialë gjenden në lartësinë mbidetare mbi 1900m. Liqeni i Livadicës, 2173 m mbi nivelin e detit, ka një gjatësi prej 230 metra, gjerësi 120 dhe thellësi 7.3m. Liqene të tjera: Liqeni i Jazhincës, Gornjasellës, Karanikollës, Miskovës, Bezdankës, etj. Liqeni i zi është liqeni më i izoluar i Maleve të Sharrit, ka përmasat e një baseni, me ujë të pandryshueshëm dhe thellësi 3.5m. Majat më të larta janë ajo maja e Bistrës (2.640), Majës së Zezë (2.584), maja e Koblicës (2.526), maja e Lubotanit (2.499m), maja e Livadicës (2.491), maja e Kullës (2.314m).

Parku Nacional i Sharrit ka 390km². Në kuadër të tij bën pjesë edhe fshati turistik Prevala, i njohur për klimën, peizazhin dhe ekoturizmin. Po ashtu, nga ky park burojnë edhe dy prej lumenjve më të njohur, Lepenci dhe Lumbardhi.

Qëndra më e njohur e skijimit është Brezovica. Hapësira e qendrës është rreth 2500 ha, në lartësinë mbidetare 1718-2522. Shtigjet kanë një gjatësi mesatare prej 4 km.

Informata të hollësishme rreth aktiviteteve të ndryshme mund të gjeni në këtë adresë:

Hotel Sharri

Prevallë, Prizren

Mobil: +377 (0) 44 501 997, ose +377 (0) 44 662 674

Email: info@hotelsharri.com, jahir-sharri@hotmail.com

Web: www.hotelsharri.com



MIRUSHA

Është atraksioni natyror kryesor i Malishevës.

Ujëvara e Mirushës shtrihet përgjatë rrjedhës së lumit Mirusha, e cila ka gdhendur një kanion të gjatë rreth 10 km, duke krijuar edhe 16 liqene lumi me 12 ujëvara. Ujëvara më lartësinë më të madhe është ajo në mes të liqenit të gjashtë dhe të shtatë. Ka lartësinë prej 21 metrash. 2 km poshtë lumit gjendet kanioni prej 16 liqenesh karstike lumore të madhësive të ndryshme të lidhura me ujëvara të larta deri 21 m. Anët e kanionit në disa vende janë të thella e vertikale deri në 200 m. Liqenet e epërme kanë një thellësi maksimale prej 6.5 m. Te liqenet e mesme lartësia është rreth 100m nga liqeni i 13-të deri te liqeni i 8-të. Thellësitë në mes ujëvarës 9-të dhe 10-të janë 6-9 m kurse lartësia e ujëvarës në formë muri në mes të liqenit 8-të dhe 9-të është 21 m dhe në mes të liqenit 9-të e 10-të është 9 m. Liqenet e poshtme karakterizohen me gjerësi të ndryshme 50-60 m në mes të dy brigejeve. Liqenet më të mëdha janë liqeni i 13-të dhe i 16-të (i fundit) me thellësi 5 -7m. Pas liqenit të 13-të ujëvara ka lartësi 3m me një rënie shumë të shpejtë në formë ujëvare që bie në liqenin e 14-të duke krijuar një ujëvarë 14 m të lartë në drejtim të liqenit të 15-të ku nga liqeni i 15-të me një lartësi të njëjtë bie në liqenin e 16-të ku edhe përfundon kanioni i Mirushës. Dimensionet e liqeneve nga i pari deri te i 16-ti, ndryshojnë varësisht nga sasia e ujit dhe reshjeve që bien në ujëmbledhësin e Mirushës.

Parku i Mirushës gjendet në të dy anët e rrjedhës së lumit Mirusha që nga fillimi i kanionit deri gati në derdhjen e tij në lumin Drini i Bardhë. Sipërfaqja e territorit të mbrojtur të Parkut Regjional të Mirushës është 556 ha.

Kontakte:

Drejtoresha e Kulturës, Blerta Krasniqi.

Email: blerta.d.krasniqi@rks-gov.net.

Tel: 044/201-250.

Mehdi Krasniqi, zyrtar në Drejtorinë e Kulturës:

Email: mehdi.krasniqi@rks-gov.net;

Tel: 049/409-852



BRODI

Është njëri prej fshatrave kryesore të goranëve, në anën lindore të Dragashit. Është njëri prej atraksioneve kryesore të ekoturizmit në rajon dhe në tërë vendin në përgjithësi. Ka një natyrë të mrekullueshme, peizazhe mahnitëse, maja të larta, kullosa që e pasurojnë rajonin me një zhvillim të konsiderueshëm blegtoral.

Po veçojmë ekoturizmin, si një arsye pse ky vend është i domosdoshëm për t'u vizituar.

Për një çiklizëm malor ekziston këto shtegu Brod – Shutman.

Për ecje në male: ecja nga Brodi deri në malin Çule. Nisja fillestare nga fshati ka lartësinë mbidetare 1384 m, ndërsa maja më e lartë e arrijtes në malin Çule është 2220 m. Gjatësia e shtegut 5.76 km.

Brod – kalimi i vjetër me IRJM-në: shëtitje e gjatë, 15 km. Pika më e lartë: 2265 m.

Baçka – Brod: Baçka ka pak familje që jetojnë në të gjatë dimrit, pasi të tjerët punojnë jashtë vendit. Pika e nisjes: fshati Baçkë; lartësia fillestare: 1250 m; pika më e lartë: 1470 m; largësia: 7.34 km.

Brod – liqeni Shutman: Një prej ecjeve më të njohura në rajonin e Brodit. Kjo shëtitje mund të kombinohet edhe me dy ecje të tjera në rajon: Mali Vracë ose ecja te 3 Majat, të cilat fillojnë dhe përfundojnë te liqeni Shutman. Pika e nisjes: Hoteli “Arxhena”; lartësia fillestare: 1384 m; pika më e lartë: 2120 m; largësia: 8.82 km.

Informata:

Hotel Arxhena

Brod, Dragash,

Tel: +381 (0) 29 285 170

Mob: +377 (0) 44 402 368

Email: info@arxhena.com

Web: www.arxhena.com







SHATËRVANI, PRIZREN

Është bërthama më e vjetër e qytetit urban të Prizrenit. Ka pësuar ndryshime të shumta gjatë kohës, por vazhdon të ketë rëndësi të madhe për trashëgiminë dhe kujtesën e qytetarëve të Prizrenit. Në mes të sheshit ndodhet kroi i Shatërvanit me katër pipëzat e tij, nga të cilat uji derdhet në një koritë rrethore të ndërtuar me gurë. Sheshi është i shtruar me gurë të latuar, me kalldrëmin “makadam”, rreth tij ka shumë dyqane e objekte të ndërtuara në shekujt e kaluar. Shatërvani është ndër vendet më të vizituara të Prizrenit. Është shëtitorja më e frekuentuar e qytetit.

SAHAT KULLA E MAHMUT PASHËS – MAMUSHË

Ndodhet në pjesën lindore të Mamushës, në oborrin e xhamisë së qytetit. Sipas burimeve kullën e orës e ndërtoi Mahmut Pashë Rrotullit në shekullin XIX, gjegjësisht në vitin 1815, që dëshmohet nga mbishkrimi që ndodhet mbi portën e kullës. Ndërtesa e Sahat Kullës së Mahmut Pashës është kënddrejtë, e pa suvatuar dhe e ndërtuar me gurë vendorë të gdhendur, e të lidhur me llaç gëlqeror. Pjesa e epërme e kullës përfundon me kulm katërujorë dhe është e mbuluar me llamarinë, kurse mbi te gjendet koka me planimetri katrore, ku ishte e vendosur ora, gjithashtu me kulm katërujorë, të mbuluar me llamarinë. Hyrja në Sahat Kullë bëhet nëpërmjet derës nga druri, me kornizë gjysmë rrethore nga gur të gdhendur. Brenda gjenden shkallët të punuara nga druri që shpijnë në pjesën e epërme të kullës. Mekanizmi i orës ekziston, por nuk funksionon. Sahat Kulla e Mamushës ka qenë funksionale deri në vitin 1979. Sahat Kulla është ndërtuar për orientimin e banorëve, për kohën e faljes, kohën e hapjes dhe mbylljes së dyqaneve etj. Kulla është vendosur në pozitë strategjike për përcjelljen e situatës, sikurse përhapja e zjarreve dhe vëzhgimi i situatës së sigurisë.

Mamushë
Drejtoria për Arsim dhe Kulturë
Xhafer Morina
044 120 312
cafermorina@hotmail.com,





MUZEU I SUHAREKES

Suhareka njihet si zonë me shumë lokalitete arkeologjike. Për të pasur hapësirë për ekspozimin e këtyre vlerave objekti i ndërtuar në vitin 1928 si shkollë, në vitin 2012 u shndërrua në muze. Ky objekt që është shfrytëzuar si shkollë fillore tani është objekti më i vjetër ekzistues në komunën e Suharekës. Objekti është ndërtuar në dy faza: në fillim ka qenë më i vogël, kurse gjatë kohës ka pasur mbindërtime. Në vitin 2012 merret vendimi për konsolidimin e tij. Gjatë intervenimit është ruajtur gjendja burimore, ndryshimet janë minimale për t'u përshtatur funksionit të ri.

Tani funksionon si Muze Arkeologjik në katin e parë, ku janë të ekspozuara artefaktet e periudhave të ndryshme të gjetura në territorin e komunës (Kasterc, Hisar dhe lokalitete të tjera). Po ashtu e ka edhe galerinë e pikturave, ku kohë pas kohe ndryshohen ekspozitat. Pikturat janë nga autorë vendas dhe të huaj.

Hyrja pa pagesë. Orari: 08 - 16 h(e hënë - e premte).

Demiz Zekolli

Tel: 044 792 345

Email: dzekolli@hotmail.com.





WINE ROUTES – RAHOVEC

Janë të vendosura në zonat e dy komunave, të Rahovecit dhe Suharekës. Rrugët e verës kanë një gjatësi të përgjithshme prej rreth 33 km, por e tërë rruga e verës mbulon një territor më të madh, pasi që në këtë zonë ka edhe prodhues të verërave dhe pika të tjera me interes. Nga ana tjetër, pothuajse çdo bodrum vere ka showroom për shitjen e verës. Dyqanet gjenden ose në bodrume ose përreth tyre. Çdo bodrum përveç verës prodhon edhe produkte të tjera, si raki vendore - “raki” dhe lëng rrushi “shira”. Vera shitet në paketime të ndryshme, duke filluar nga 1 shishe deri në paketimin standard prej 6 shisheve, si dhe “kuti” paketë 3 litra dhe 5 litra. Gjithashtu bodrumet si: “Stone Castle”, “Bodrumi i vjetër”, “Biopak”, “Eko”, “Agroalf”, “Daka”, “Sefa Wine” “Agrokosova Holding” (Suharekë), “Rahovera”, “Bahá “ kanë pika të vogla të shijimit të verërave si: Chardonnay, Rhine Riesling, Cabernet Sauvignon, Merlot, Pinot Noir, Shiraz, Vranac, Rose etc, dhe natyrisht të veçantën “raki”.

Ture për wine routes

Ka disa operatorë që ofrojnë ture për Wine Routes në rajonin jugor:
Nëse jeni në Rahovec, kontaktoni Qendrën e Informacionit Turistik në:
Komunën e Rahovecit, Rr Xhelal Hajda-Toni

Mob: +377 (0) 45 471 787

e -mail: info@wineroutes-ks.com ose e-mail: tourism.rahovec@gmail.com

Ose Kosovo Wine Association “Enologjia” që ndodhet në “Wine House” në rrugën nga Rahoveci në Xërxë, në afërsi të verarisë “Stone Castle” Veraria.

Mob: +377 (0) 44 60 42 88 ose 377 (0) 45 471 787

E-mail: enologjia@wineroutes-ks.com

Vector Travel, Prizren,

Tel: +381 (0) 29 242 804;

Mob +377 (0) 44 119 284;

E-mail: vector_ak@hotmail.com;

www.vectortours.com

Për më shumë informacione vizitoni faqen e internetit: www.wineroutes-ks.com





BOZË, TULLUMB, SUTLAQ

Boza është pije freskuese e shëndetshme, e përvetësueshme dhe shumë e shijshme. Konsumohet edhe në dimër. Pija është sajuar për herë të parë nga goranët e Dragashit, të cilët e prodhuan nga mielli i misrit. Nëse ju jeni në qytetin e Prizrenit, duhet ta keni parasysht se ka një lokal ku kjo pije shërbehet në një mënyrë të veçantë, e shoqëruar me tullumba dhe sutlaq.



ÇKA NUK MUND TË SHMANGNI

Botues: EC Ma Ndryshe dhe gjashë komunitat e rajonit të Prizrenit

Ekipi redaktues: Arben Idrizi (redaktor), Vesel Hoxhaj dhe Hekuran Kabashi (historianë), Margarita Azizi (hulumtuuese), Samir Karahoda (fotograf)

Dizajn, radhitje dhe shtyp: Scards (www.scards.com)

Përkthim: CITS

Ky publikim është realizuar në kuadër të projektit “Mbështetje për sektorin e turizmit në Rajonin Ekonomik Jug”, që përkrahet financiarisht nga Ministria për Punëve të Jashtme të Finlandës në suaza të projektit “Ndihmë Tregtisë”, implementuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).

Të gjitha të drejtat e rezervuara ©

Prizren, Kosovë, 2015

